



BIOLOGJI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

MAJ, VITIT MËSIMOR 2015/2016

UDHËZIME

KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT ËSHTË 60 MINUTA

Mos e hapni testin pa lejen e administruesit të testit.

Punimi i nxënësit duhet të jetë i shkruar me laps kimik.

Lexoni me kujdes çdo pyetje.

Lexoni me kujdes udhëzimet të cilat janë shkruar para çdo grupi të pyetjeve.

Në pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni shkronjën para përgjigjes së saktë. Me rastin e dhënies së përgjigjeve në pyetjet nga 7 deri në 10 plotësoni tabelat me kujdes.

Në pyetjet nga 11 deri në 20 qartë dhe saktë shkruani përgjigjet në vendin e paraparë për to.

Nëse jepni përgjigjen në disa mënyra, tregoni përgjigjen të cilën duhet ta vlerësojnë vlerësuesit.

Pyetja do të vlerësohet me 0 pikë nëse:

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë (grafit)

Nëse gaboni, vendosni një vijë të kryqëzuar mbi përgjigjen e dhënë dhe jepni përgjigjen e re.

Nuk lejohet përdorimi i korrektorit.

Ju dëshirojmë sukses të plotë!

SHIFRA E NXËNËSIT

FAQJA E ZBRAZËT

Ne pyetjet prej 1 deri në 6 rrethoni shkronjën para përgjigjes së saktë.

1. Barkushet palcore janë të përmbushura me:

- A. masën e bardhë
- B. likuorom
- C. limfë
- D. masën e përhimë

2 pikë

2. Prania e cilit acid është i domosdoshëm për veprimin e pepsinës në lëngun e lukthit?

- A. azotik
- B. fosforik
- C. klorhidrik
- D. sulfuror

2 pikë

3. Shtrembërimi i kurrizit në një anë quhet:

- A. Kifoza
- B. Osteoporozë
- C. Rahitisi
- D. Skolioza

2 pikë

4. Cili nga insektet e dhëna kanë metamorfozë jo të plotë?

- A. dykrahërorët
- B. krahmembranorët
- C. krahdrejtët
- D. krahfortit

2 pikë	
--------	--

5. Cila nga algët e dhëna është njëqelizore?

- A. Koralina
- B. Laminarija
- C. Klorela
- D. Sallata e detit

2 pikë	
--------	--

6. Mitokondret janë organele:

- A. të rëndësishme për prodhimin e proteinave
- B. të rëndësishme për prodhimin e acideve nukleike
- C. të rëndësishme për prodhimin e energjisë
- D. të pranishme vetëm në qelizat shtazore

2 pikë	
--------	--

Në pyetjet prej 7 deri në 10 me kujdes plotësoni tabelat.

7. Shënoni X në vendet përkatëse në tabelë ashtu që saktë të bëni lidhjen e pohimit me klasën e farëveshurave me të cilën ka të bëjë.

Pohimet	Monokotilet	Dikotilet
Fara ka dy fletëza embrionale.		
Rrënja është rrjetore.		
Fryti shpesh është i thatë.		
Kërçelli është i gjelbër dhe druror.		

2 pikë

8. Në vendet përkatëse në tabelë shënoni X ashtu që të lidhni grupin e kafshëve me tipin përkatës të simetrisë.

Grupi i kafshëve	Dyanësore	Rrezore
Grykorët		
Krimbat cilindrik		
Krimbat unazor		
Gjemborët		

2 pikë

9. Shënoni X para pohimit përkatës (saktë ose pasaktë).

Pohimi	Saktë	Pasaktë
Kripërat minerale u japin fortësi eshtrave.		
Rahitisi paraqitet për shkak të mungesës së vitaminës C.		
Në sipërfaqe të eshtrave shpatuk gjendet periosti.		
Qelizat e palcës ashtrore ndahen dhe japin masën ashtrore.		

2 pikë

10. Plotësoni tabelën ashtu që saktë t'i radhitni fazat në procesin e shkëmbimit të gazrave.

1. lidhja e dioksidit të karbonit me hemoglobin
2. frymënxirrja
3. kalimi i oksigjenit në qelizë
4. kalimi i dioksidit të karbonit nga qeliza në kapilare
5. frymëmarrja
6. lidhja e oksigjenit me hemoglobin
7. kalimi i dioksidit të karbonit nga kapilaret e mushkërive në alveola
8. procesi i frymëmarrjes qelizore

--	--	--	--	--	--	--	--

1 pikë

Në pyetjet nga 11 deri në 20 shënoni përgjigjet në vendin e paraparë për to.

11. Kategoria më e vogël sistematike është _____.

Kategoria më e madhe sistematike është _____.

2 pikë	
--------	--

12. Bakteret janë prokariot sepse _____.

1 pikë	
--------	--

13. Organizmi i cili me praninë e vet tregon për cilësinë e mjedisit jetësor quhet


_____.

1 pikë	
--------	--

14. Në murin e trupit të kimbave për të parën herë në evolucion paraqitet shtresa e tretë e qelizave që quhet _____.

1 pikë	
--------	--

15. Shënoni emërtimet e pjesëve të veshit të shënuara me numra në figurë.



1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____

3 pikë

16. Nocionet e dhëna kanë të bëjnë me ndërtimin, formën dhe proceset jetësore të baktereve. Plotësojeni tabelën me shkronjat përkatëse.

A. ndarja e thjeshtë
E. saprofitet
I. monera

B. qepallëza
F. parazitët
J. prokariotët

C. bacilet
G. spirilet
K. autotrofet

D. koket
H. kërbaci

BAKTERIJE					
BOTA	NDËRTIMI I QELIZËS	FORMA	SHUMËZIMI	LËVIZJA	TË USHQYERIT

3 pikë

17. A. Pluhërimi është _____

B. Frytënimi është _____

2 pikë

18.



Figura 1



Figura 2

A. Në figurat 1 dhe 2 janë paraqitur stadet në zhvillimin e një bime. Për cilën bimë bëhet fjalë?

Përgjigje: _____

B. Si quhen ato stade (fazat)?


Përgjigje:

1. _____

2. _____

2 pikë

19.



A. Qeliza në figurë paraqet njësinë bazë të sistemit nervor dhe quhet

_____.

B. Shkruaji emërtimet e pjesëve të asaj qelize të shënuara në figurë.

1. _____

2. _____

3. _____

3 pikë

20. Plotësoni tabelën në atë mënyrë që për çdo bimë të dhënë të shënoni familjen që i takon.

Bima	Familja
Qarri	
Lakra	
Dardha	
Dhiozma	
Misri	

3 pikë

E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2016